



**VENDIM**

**Nr. 113 Datë 28.12.2010**

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“HEC DUNICE” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC DUNICE” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “HEC DUNICE” sh.p.k plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 të nenit 9, përkatësisht me miratimin nga Cez Shpërndarja (O.S.SH) të pikes së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, është në proces miratimi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Bordi i Komisionereve



---

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për liçensimin e shoqërisë “HEC DUNICE” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Trebinje”, “Potgozhan”, “Kalivac”, “Dunice 1”, “Dunice 2”.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.